

# Sëmundja e Alzheimerit

FLETUSHKA FAKTIKE NGA QENDRA SUEDEZE PËR DEMENS

Alzheimers sjukdom • faktablad på albanska

## Sëmundja më e rëndomtë e demensit

Demens është emër i përbashkët i të gjitha simptomave, që vështirësojnë të menduarit, planifikimin dhe komunikimin.

Këto simptoma janë rezultat i dëmtimeve dhe sëmundjeve të ndryshme të trurit.

Sëmundja më e rëndomtë e trurit është e ashtuquajtura sëmundja e Alzheimerit që përbën 60–70 % të të gjitha rasteve të sëmundjeve demens.

## Jo e zakonshme para moshës 65 vjeçare

Llogaritet se në Suedi përafërsisht 100 000 persona vuajnë nga sëmundja Alzheimer. Sëmundja nuk është e zakonshme para moshës 65 vjeçare, por me kalimin kohës rritet rreziku për tu sëmur nga kjo sëmundje. Në grupmoshën 70–74 vjeç më pak se 4% kanë sëmundjen Alzheimer deri sa në grupmoshën 90 vjeç përafërsisht çdo i treti.

## Çka ndodh me trurin

Në sëmundjen Alzheimer fillon proteina amylobeta të mbledhet dhe vendoset midis qelizave nervore të trurit. Në qeliza formohen fibrile, toptha të vegjël që pamundësojnë bartjen e substancave të ndryshme ushqyese. Për shkak të këtyre ndryshimeve, gradualisht dëmtohen pjesë të trurit. Zhvillimi i kësaj sëmundje zgjat për shumë vite.

## Sëmundja vjen fshehurazi

Sëmundja e Alzheimerit vjen fshehurazi. Shpesh ngatërrohet gabimisht si plakje natyrore. Simptomat e hershme janë harresa dhe problem për tu orientuar në mjedise të pa njohura. Personi ka vështirësi për të marrë njohuri të reja. Gjërat që më parë ishin të thjeshta, i bëhen të komplikuar dhe të bezdisshme. Edhe shqetësimet e brëndshme gjithashtu mund të jenë pjesë përbërëse e sëmundjes.

## Simptomat e hershme të sëmundjes:

- Përvetësimi i njohurive të reja vështirësohet
- Harresa
- Vështirësi në gjetjen e fjalës gjatë të folurit
- Shqetësime

## Simptomat shtohen dhe janë më të theksuara

Gradualisht përkeqësohen edhe aftësi të tjera si për shembull: të folurit, orientimi në kohë si dhe perceptimi i drejtë. Sëmundja vështirëson komunikimin

Ndihma për tu veshur, higjena dhe perkujdesi personal, me kohën bëhen të domosdoshme.

## Diagnostifikimi në kohë është i rëndësishëm

Drejtohuni mjekut në qoftë se dyshoni në sëmundjen Alzheimer.

Duhet sa më herët të bëhen

kontrolltet mjeksore. Sëmundja nuk mund të përcaktohet lehtë. Diagnostifikimi bazohet në testime të ndryshme, kërkime mjeksore si dhe biseda me familjarë. Hulumtimet mund të marrin disa javë.



## Mjekimi dhe trajtimi

Studimet rreth sëmundjes Alzheimer kanë përparuar shumë, por deri tani ende nuk ekziston trajtimi mjekësor për parandalimin dhe shkrimin e sëmundjes. Megjithatë ekzistojnë barna, të cilat në fazën e hershme, ulin intesitetin e simptomave të sëmundjes. Mjete ndihmëse dhe masa tjera mund të lehtësojnë jetën e përditshme.

Është e rëndësishme që simptomat të përshkruhen në mënyrë që të bëhet planifikimi për një jetë sa më të mirë. Gjithashu është me rëndësi që të sëmurit ti sigurohet qetësi, pasi nga stresi simptomat bëhen më të theksuara. Ndihma, mbështetja si dhe perkujdesja e institucioneve sociale dhe shëndetësore me kohën bëhen më së të nevojshme.

30 janar 2016 • Svenskt Demenscentrum®

Më shumë informata në gjuhët e ndryshme mund ti lexoni në portalin Qendra Suedeze për demens:  
[www.demenscentrum.se/Faktablad](http://www.demenscentrum.se/Faktablad)



Svenskt Demenscentrum

Svenskt Demenscentrum, Gävlegatan 16, 113 30 Stockholm, 08 - 690 58 00, [info@demenscentrum.se](mailto:info@demenscentrum.se)

[www.demenscentrum.se](http://www.demenscentrum.se)